



| | | | |
|--------------------------------------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Primijeno/Prilatu Received/Delivruy | 25.01.2021 | 1 | viti god year |
| Organ /Njesia Organ /Jedinita Org /Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKIMSHCK | 285/2021 | | 1/3 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A. Nr.442/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A. nr.442/2020 të datës 30.12.2020, të parashtruar nga ankuesi me adresë Instituti i Mjekësisë Ligjore, Q.K.U.K, Prishtinë, kundër organit të punësimit Ministria e Drejtësisë, në çështjen juridike " *mase disiplinore* ", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 25.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën A. nr. 442/2020 të datës 30.12.2020, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi Toksikolog Mjeko Ligjor në Institutin e Mjekësisë Ligjore, me datë 30.12.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokollit 3345/2020, e regjistruar me A. nr. 442/2020, kundër Vendimit KD-Nr.02/2020 të datës 02.12.2020, të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë, me të cilin i është shqiptuar masa disiplinore „ *ndalim i pagës bazë prej 30% për periudhën katër mujore nga dita kur vendimi merr formën e prerë*”.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 05.01.2021 ka proceduar tek Ministria e Drejtësisë kërkesën për përgjigje në ankesë. Këshilli me datë 20.01.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesës ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr.442/2020, me numër protokollit 3345/2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin

Civil të Kosovës; Vendimin e datës 20.11.2020, A. Nr. 294/2020, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e datës 07.08.2020, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; e-mailin e datës 11.08.2020; Kontratën e Punës të datës 01.03.2018, te ankuesit

Vendimin e datës 07.09.2020, për Formimin e Komisionit Disiplinor; e-mailin e datës 02.11.2020; i Udhëheqëses së Divizionit për Burime Njerëzore; kërkesën e datës 08.10.2020, për inicimin e procedurës disiplinore; e-mailin e datës 11.03.2019; e-mailin e datës 27.05.2019; e-mailin e datës 20.11.2019; e-mailin e datës 11.02.2020; Procesverbalin e datës 04.11.2020, të Komisionit Disiplinor; Raportin për prezencën në Punë për periudhën 01.03.2018-31.07.2020;

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, të parashtruara nga palët, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, është jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.442/2020 të datës 30.12.2020, e parashtruar nga ankuesi

sepse;

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Vendimi KD-Nr.02/2020 i datës 02.12.2020, i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë, është marrë nga Komisioni i cili në përbërjen e tij është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 2, nen paragrafi 2.2 dhe nenin 72 paragrafi 4 nen paragrafi 4.1,4.2,4.3 dhe 4.4 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, si dhe nenin 17 të Rregullores (QKR) Nr. 11/2020 për Disiplinën e Zyrtarëve Publikë, dhe se me rastin e shqiptimit të masës disiplinore nuk është marrë parasysh integriteti profesional dhe personal i ankuesit. Me tutje deklaroi se ai më përpikëri ka respektuar Kontratën e Punës dhe obligimet që burojnë nga kjo, andaj kërkon nga KPMSHCK-ja të aprovoj ankesën si të bazuar, të anuloj formimin e përbërjes së Komisionit Disiplinor dhe të refuzoj vendimin e Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë.

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesi ka themeluar marrëdhënie pune me Ministrinë e Drejtësisë, bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, në pozitën e punës me titull "Toksikolog Mjeko Ligjor, me kohë të pacaktuar. Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Drejtësisë, bazuar në kërkesën e Drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore të datës 08.10.2020, ka zhvilluar procedurën disiplinore ndaj ankuesit për shkak të mungesës së vazhdueshme në punë si dhe mos përmbushjes së detyrave të punës. Me vendimin KD-Nr.02/2020 të datës 02.12.2020, Komisioni Disiplinor ka shqiptuar ndaj ankuesit masën disiplinore "ndalim i pagës bazë prej 30% për periudhën katër mujore nga dita kur vendimi merr formën e prerë". Kundër këtij vendimi, ankuesi me datë 30.12.2020, ka parashtruar ankesë në Këshillin Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës bazuar në Kontratën e Punës të datës 01.03.2018, ka konstatuar se ankuesi ka statusin e nëpunësit të shërbimit publikë ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 2 paragrafi 4 të Ligjit NR. 06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, ku parashihet se "4. Nëpunësi i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike. Andaj, meqenëse ankuesi nuk ka statusin e nëpunësit civil, rrjedhë së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për ankesën A. nr. 442/2020 të datës 30.12.2020, të parashtruar nga ankuesi



Bazuar nenin 6 paragrafi 1, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent për të vendosur vetëm për nëpunësit civil dhe kandidatet për pranim në Shërbimin Civil, të përcaktuar në nenin 2 paragrafi 2 nen paragrafi 2.1 dhe paragrafi 3 si dhe nenin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas konstatimit se Këshilli nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.*

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shtjellimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A. Nr. 442/2020

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj, Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Mjekësisë Ligjore;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Drejtësisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së